

PASQYRA FINANCIARE MË TË VËRTETA DHE GJITHPËRFSHIRËSE PASSJELLIN PERFITIME RECIPROKE PËR BANKËN DHE BIZNESIN

Përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare janë: investitorët, huadhënësit, zyrat e taksave, furnitorët, klientët, të punësuarit, qeveria me agjencitë e saj dhe publiku.

Roli dhe mbështetja e Bankave, shoqërive të leasingut dhe kreditorëve të tjerë është shumë i rëndësishëm për njësitë ekonomike shqiptare (sidomos për Njësitë Ekonomike të Vogla dhe të Mesme – NVM / SME) të cilat nuk kanë akses në tregjet e kapitalit. Për këtë Bankat e kanë të nevojshme të aksesojnë rregullisht informacionin e raportimit financiar të entiteteve që kërkojnë të mbështeten me hua.

Bankat i përdorin paqyrat financiare të njërive ekonomike për të matur përfitueshmërinë, likuiditetin/ fluksin e mjeteve monetare në mënyrë që të përcaktojnë aftësinë e tyre për të kthyer huanë. Analiza financiare kredituese është shumë e rëndësishme për Bankat jo vetëm në momentin e vendimarrjes për huadhenien por edhe për monitorimin përgjatë gjithë jetës së kredisë.

Dua të theksoj dhe njëkohësisht të falenderoj që në procesin e ndryshimeve të ndërmara për përmirësimin e raportimit financiar të SKK-ve janë përfshirë grupet e ndryshme të interesit. Bankat dhe Shoqëritë e Leasingut janë bërë pale të këtij projekti që në hapat e para të tij, nëpërmjet anketimit ku janë identifikuar pikat e forta dhe të dobta të SKK-ve ekzistuese. Më tej, angazhimi i bankave vazhdoi me pjesëmarrjen aktive në takime të përbashkëta për të identifikuar pikat ku ishte e nevojshme të ndërhyhej për përmirësimin e SKK-ve dhe krijimin e një strategjie për këtë qëllim.

Para fillimit të këtij projekti, përdoruesit e pasqyrave financiare kishin si burim të vetëm të marrjes së informacionit vetë njësinë ekonomike (në raste shumë të rralla kompanitë i pasqyrojnë PF online në websitet e tyre). Tashmë pasqyrat financiare reflektohen në një institucion kombëtar sic është Qendra Kombëtare e Regjistrimit QKR (sot Qendra Kombëtare e Biznesit QKB). Edhe pse ky reflektim bëhet vetëm një herë në vit dhe pas gjashtëmujorit të parë të vitit pasardhës të raportimit ka rezultuar shumë ndihmues në analizat tona financiare kredituese.

Një nga sfidat themelore për përdoruesit e PF është *besueshmëria* e tyre. Informaliteti i lartë në vend, fakti që Shqipëria është ende një ekonomi cash-i, ndikojnë drejtpërdrejt në raportimet financiare vecanërisht të njërive të vogla dhe të mesme dhe rrjedhimisht mund të pengojnë kreditimin apo të cojnë në vendimarrje të gabuara nga institucionet financiare.

Përgjithësisht bizneset e vogla private në vendin tonë kanë një strukturë organizimi të cunguar gati-gati primitive, administrohen nga vetë pronari ose nga familjarë të tij. Kostot e ulëta dhe mundësia për të shmangur mashtrimet hierarkike janë ndër të paktat të mira të këtij lloji administrimi. Duke e administruar vetë biznesin, pronari ka kontroll absolut cka mund të cojë në “qëndisje” të të dhënave financiare (note: Para disa vitesh ishte i njohur fenomeni i përpilimit të dy pasqyrave financiare “një për tatimet dhe një për vete biznesin”, fenomen i cili është minimizuar dukshëm vitet e fundit).

Nga ana tjetër, jo rrallë herë, mungesa e njohurive të nevojshme mund të cojë pronarin në pasqyrime dhe regjistrime të pasakta në pasqyrat financiare: Asete fikse të paregjistruara ose të parivlersuara, Inventar matematikor, mos-reflektim i borxheve (shpesh herë edhe kredia e finacuar nga vetë banka), mos-shpërndarje dividendi dhe krijim fiktiv i detyrimeve ndaj aksionerit, pasqyra jo reale të fluksit të parasëtej etj... Këto janë vetëm disa nga problematikat

e hasuara gjatë analizave tona kredituese të cilat ndikojnë në drejtim/ përcaktimin e riskut të klientit.

Për Alpha Bank përgatitja e PF vjetore individuale dhe/ose të konsoliduara në bazë të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit dhe vecanërisht *auditimi i tyre nga një palë e tretë* e pavarur, është e një rëndësie thelbësore.

Brenda konceptit të pasqyrimin sa më të vërtetë të situatës financiare të njësisë ekonomike, kontrolli/auditimi është një kërkesë eksplicite. Të lejuarit e përcaktimeve subjektive nga menaxhmenti lidhur me pasqyrimin financiar, do të passillte vendimarrje të gabuara që mund të gjenerojnë probleme jo vetëm për palët (Biznes dhe Bankë) por edhe më gjerë, për gjithë shoqërinë. Për të parandaluar pasoja negative siç është transparenca e zvogëluar, mungesa e qëndrueshmërisë dhe krahasueshmërisë, është e rëndësishme të krijohen metoda të aprovuara dhe lehtësisht të aplikuara për monitorimin e pasqyrave të përpiluara nga bizneset.

Në Shqipëri disa njesi ekonomike janë ligjërisht të përjashtuara nga detyrimi ligjor i auditimit (Neni 41 Nr.10 091, datë 5.3.2009) duke e vënë bankën përballë një situatë të pasigurt. Shpesh herë Alpha Bank Albania, kur e ka gjykuar të nevojshme (duke marrë parasysh kostot dhe përfitimet e të dyja palëve), i ka kërkuar klientëve të saj auditimin e pasqyrave financiare. Me keqardhje kemi konstatuar se shumë rrallë kjo kërkesë është mirëkuptuar dhe pranuar nga njësia ekonomike.

Alpha Bank përdor sisteme të sofistikuar rejtimi për të përcaktuar riskun e klientit, ku një peshë të rëndësishme në përcaktimin e tij kanë të dhënat financiare dhe fakti nëse ato janë apo jo të audituara. Kompanitë e rejtura me risk të ulët apo të mesëm përgjithësisht shpërblehen me ulje në cmimin e kredive duke lehtësuar aftësinë paguese dhe duke i dhënë me shumë frymëmarrje biznesit, cka do të ndikonte drejtperdrejt në mjaftueshmërinë e kapitalit të Bankës. Pra duke dhënë përfitime për të dyja palët në këtë proces.

Sistemet tona të rejtimit mund të bëjnë krahasimin e të dhënave financiare me njësi të ngjashme që operojnë në të njëjtën fushë/ industri. Por për shkak të mungesës të të dhënave statistikore për tregun shqiptar ky algoritëm është pothuajse jo funksional.

Disa çështje të tjera që u ngritën nga Bankat që në hapat e para të këtij projekti ishin: Përpilimi i raporteve të konsoliduara (SKK 9) për kompanitë holding apo edhe ato kompani që kanë transaksione ndërmjet tyre në një nivel aq të lartë sa është e vështirë t'i shohësh të ndara. *Koncepti i Grupit* është një nga konceptet më të rëndësishme në analizat e kreditimit sot, mbështetur shumë edhe nga Banka e Shqipërisë.

Në vijim, në këndvështrimin e bankave, *raportimi i segmentuar* për njësitë ekonomike që ushtrojnë më shumë se dy aktivitete të ndryshme është gjithashtu një pikë ku ia vlen të ndërhyhet. Në përputhje me SKK, zërat e tyre duhet të paraqiten në një grup më vete, në pasqyrën e aktiviteteve, të ndërtuar sipas funksionit.

Gjithashtu u kërkua nga Bankat që të bëhej i detyrueshëm *rakordimi mes fitim/humbjes kontabël me fitim/ humbjen tatimore* (sipas SKK ishte fakultative).

Së fundi, një çështje tjetër që është identifikuar si problematike nga Bankat gjatë këtij projekti ka qenë informacioni që përcillet nga *Shënimet Shpjeguese*. Një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues që i jep mundësi përdoruesve të pasqyrave të saj financiare për të vlerësuar natyrën dhe efektin financiar të çdo zëri dhe të pasqyrojnë zërat jashtë bilancit, të japin informacion për çështjet gjyqësore etj. Falë instruksioneve dhe shembujve të përfshira në SKK-të e ndryshuara, ne kemi vënë re një përmirësim në këtë drejtim.

Jo vetëm që nga fillimi i këtij projekti, por edhe më parë, Alpha Bank ka luajtur një rol këshillues në marrëdhënien me biznesin (klientet e saj) duke theksuar nevojën dhe rëndësinë e përpilimit të pasqyrave financiare konform SKK-ve si dhe duke identifikuar specifikisht parregullsi të vërejtura dhe duke i nxitur dhe motivuar bizneset t'i përpilojnë PF në përputhje me këto standarde. Në disa raste sygjerimet janë marë në konsideratë dhe biznesi ka bërë korrigjimet përkatëse të cilat më pas janë depozituar edhe në zyrat e taksave duke e formalizuar të gjithë procesin.

Në vetvete, Standardet e tanishme Kombëtare të Kontabilitetit janë me siguri më afër Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për SME-të, duke na afruar më shumë drejt standardizimit të pasqyrave financiare në Bashkimin Europian, por, adoptimi i tyre mbetet akoma një sfidë për kompanitë shqiptare.

Më shumë kohë është e nevojshme që impakti këtyre ndryshimeve /përmirësimeve të jetë i dukshëm dhe eficient.

Si përfaqësuese e Alpha Bank dua të theksoj se Banka jonë do të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm në këtë proces bashkëpunim të ngushtë me bizneset (klientët tanë).

Aktualisht, Alpha Bank po përgatit një program gjithëpërfshirës trajnimi për punonjësit që janë pjesë e procesit të kreditimit, ku vend të rëndësishëm zë analiza financiare. Është menduar që në bashkëpunim dhe duke u konsultuar me Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit të përfshijmë në këtë program trajnimi edhe ndryshimet aktuale të SKK-ve.